



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2023, mori këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për z. Adhurim Uka, me vendbanim në Prishtinë, si pasojë e djegies së shtëpisë.
- II. Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës I të këtij Vendimi, do të jetë 10.000 € (dhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, mjete nga të hyrat vetanake.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti nga Brigada profesionale e zjarrfikësve – Prishtinë, dhe konstatimi i dëmit të shkaktuar nga zjarri nga Drejtoria e Inspeksionit – Sektori për siguri dhe emergjenca, dt. 20.03.2023, sipas kërkesës, nr. 01-016/01-61539/23, dt. 22.03.2023, të cilën e dëshmojnë edhe fotot nga vendi i ngjarjes.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-016/01-69238/23, më 03.04.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

